



KONTRATE AKT - THEMELIMI

"AutoMaster" shpk

Sot me date / Mars / 2007 ne Tirane, te nenshkruarit:

Union Grup shpk, rregjistruar ne Gjykatene e Rrethit Tirane me vendimin nr. 26016, date 25.06.2001, me adresen ne: Bulevardi Zog I, Pall. Jeshil 13 kate perballë stacionit te trenit, e perfaqsuar nga Z. Niko Leka, me zotesi te plete juridike per te vepruar, vendosën me vullnetin e tyre te lire per sa me poshte vijon:

- Neni 1** Te themelojne një shoqeri tregtare te tipit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.
- Neni 2** Jetegjatesia e shoqerise eshte e pacaktuar.
- Neni 3** Emertimi i shoqerise do te jetë **"AutoMaster" Shpk**, me Seli ne adresen: Rr.Kavajes, P. MAKO, Nr.72, Tirane.
- Neni 4** Shoqeria do te kete per objekt:
- Kryerjen e sherbimeve ndaj automjeteve te cdo lloji, tipi e tonazhi, te reja ose te perdorura,
 - Tregtim pjesesh kembimi auto,
 - Tregtim te cdo lloj malli qe ka te beje me cdo lloj automjeti qe eshte ne qarkullim, perfshire bateri, goma te cdo lloji, pajisje e pjese kembimi per lavazh, etj.
 - Tregtim automjetesh te cdo lloji, tipi e tonazhi, te reja ose te perdorura,
 - Dhenien me qira te automjeteve te cdo lloji dhe cdo veprimtari tjeter te mundshme ne permbushjen e ketij qellimi,
 - Celjen e autoshkollave per te mundesuar licensimin e drejtuesve te mjeteve motorike te te gjitha llojeve,
 - Krijimin e te gjithe infrastrukturës per te ofruar sherbime ne lidhje me permbushjen e te gjithe procedurave te nevojshme qe duhet te kryhen nga ana e pronareve te mjeteve motorike per pajisjen me te gjithe dokumentacionin përkates te mjeteve te tyre motorike,
 - Te gjitha aktivitetet tregetare qe nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar.

Objekti i shoqerise mund te ndryshohet vetem me vendim te Ortakeve.

Neni 5 Kontributet per themelimin e shoqerise

1. Kontributet ne para

Ato sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim, ne nje banke te nivelit te dyte, siç rezulton edhe nga certifikata e ieshuar nga banka e mesiperme, nga ortaku:

Union Grup 5,000,000 Lek

Shuma e kapitalit ne para eshte 5,000,000 (Pese milion) Lek

2 -Kontributi ne natyre

Asnje prej ortakeve nuk sjell kontribute ne natyre

3 - Totali i kontributeve:

Kontributet ne para arrijne ne Lek 5,000,000.00

Kontributet ne natyre arrijne ne -----

Totali i kontributeve arrin ne Lek 5,000,000.00

NENI 6 – Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fiksohet ne 5,000,000 Lek (Pese milion)

Ai ndahet ne 5,000 pjesa te kapitalit themeltar prej 1,000 Lek secila, te gjitha te nenshkuara dhe te paguara teresisht.


Pjeset e kapitalit themeltar ndahen si me poshtë:

Emri	Shuma Lek	Pjeset e kapitalit	Numri rendor
1. Union Grup	5,000.000	100%	1-5,000

Totali i barabarte me numrin e pjesave qe perbejne kapitalin themeltar: 5,000,000 Leke.

Te nenshkuarit deklarojne se te gjitha pjeset jane nenshkuar teresisht, derdhur plotesisht dhe ndare siç tregohet me lart.

Ortaket themelues



Union Grup

Perfaqsuar nga Z. Niko Leka

STATUT

I SHOQERISE TREGETARE "AutoMaster" sh.p.k.

"Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit", si dhe ligit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me vullnetin e tyre te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij statuti dhe ne aktin e themelimit,

Union Grup shpk, rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane me vendimin nr. 26016, date 25.06.2001, me adresen e: Bulevardi Zog I, Pall. Jeshil 13 kate perballle stacionit te trenit, e perfaqsuar nga Z. Niko Leka, me zotesi te plete juridike per te vepruar shpallin si vijon:

NENI 1 : EMRI, THEMELUESIT DHE VULA E SHOQERISE

Formohet shoqeria tregetare "AutoMaster sh.p.k." me themelues Union Grup shpk. Shoqeria ka simbolin dhe vulen e saj, qe permajne germat AutoMaster sh.p.k. ne nje forme te stilizuar. Konfiguracioni i vules do te percaktohet nga administratori i saj, dhe mund te ndryshoje koha pas kohe duke njofuar paraprakisht ortaket e shoqerise.

Emri i plete i Shoqerise dhe adresa e qendres se saj duhet te perfshihet ne te gjitha aktet dhe dokumentat e leshuar nga Shoqeria tek te tretet.

NENI 2 : FORMA JURIDIKE

Shoqeria tregetare "AutoMaster sh.p.k." eshte shoqeri me perqiegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

NENI 3 : SELIA

Shoqeria e ka seline e saj ne **Rr. Kavajes, P. MAKO, Nr.72, Tirane**. Cdo ndryshim i selise do te behet me miratim te ortakeve te saj. AutoMAster shpk mund te hape dhe seli te tjera te dyta, dege filiale, si dhe agjenci operative ne te gjithe teritorin e R.SH. Me miratim te ortakeve te shoqerise dhe sipas legjisacionit ne fuqi AutoMaster shpk mund te hape jashte vendit perfaqesi, filiale ose dege te saj.

NENI 4 : APATI KOHOR

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj ekonomike ne nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe per çfaredo shkaku me vendimin e ortakeve qe perfaqesojne $\frac{1}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise.

NENI 5 : OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se AutoMaster sh.p.k. do te jetet:

- Kryerjen e sherbimeve ndaj automjeteve te cdo lloji, tipi e tonazhi, te reja ose te perdonura,
- Tregtim pjesesh kembimi auto,





Tregtim automjetesh te cdo lloji, tipi e tonazhi, te reja ose te perdonura,
Tregtim te cdo lloj malli qe ka te beje me cdo lloj automjeti qe eshte ne
qarkullim, perfshire bateri, goma te cdo lloji, pajisje e pjesa kembimi per lavazh,
etj.
Ushtimin e aktivitetit te cdo lloji qe ka te beje me marketingun ne per gjithesi
dhe me automjetet ne vecanti,
Dhenien me qira te automjeteve te cdo lloji dhe cdo veprintari tjeter te
mundshme ne permbushjen e ketij qellimi,
Celjen e autoshkollave per te mundesuar licensimin e drejtuesve te mjeteve
motorike te te gjitha llojeve,
Krijimin e te gjithe infrastrukture per te ofruar sherbime ne lidhje me
permbushjen e te gjithe procedurave te nevojshme qe duhet te kryhen nga ana e
pronareve te mjeteve motorike per pajisjen me te gjithe dokumentacionin
perkates te mjeteve te tyre motorike,
Te gjitha aktivitetet tregetare qe nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar.

NENI 6 : KAPITALI DHE NDRYSHIMET E TIJ

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 5,000,000 leke, i ndare ne 5,000 pjesa, me vlore nominale 1,000 leke secila, e perbere nga kontributi i themeluesve ne *cash* me perqindje per te gjithe ortaket si me poshte:

Union Grup shpk	5,000,000 Leke	100 %
-----------------	----------------	-------

Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit te ortakeve qe perfaqesojne $\frac{1}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise. Kapitali i shoqerise mund te te shtohet me mjete likuide ne llogarite e shoqerise ne bankat vendese ose ne asete te tjera lehtesish te kthyeshme ne likuiditet.

NENI 7 : ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet ose zvogelohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve ne te cilin duhet te marrin pjesa ortaket qe perfaqesojne te pakten $\frac{1}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Cdo vendim per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit duhet te perfshije hollesi mbi afatet dhe menyren e pageses ose te zvogelimit te pjeseve te kapitalit.

NENI 8 : TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR*

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet do te behet vetem me pelqimin me shkrim te te gjithe ortakeve te Shoqerise. Ky paragraf nuk zbatohet kur personi perfittues i transferimit eshte ortak i shoqerise.

Ortaket kane te drejten e parablerjes se pjeses se kapitalit themeltar.

NENI 9 : DISPONIMI I PASURISE

Shoqeria tregetare "AutoMAster sh.p.k." eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe mund te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet. Ne Republiken e Shqiperise

kjo shoqeri gezon te drejta si c'do person tjeter juridik shqipetar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi.

NENI 10 : PERGJEGJESIA E ORTAKEVE

Shoqeria tregetare "AutoMaster sh.p.k." vepron ne regjistrin e prones dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kapitalit te saj. Themeluesit e shoqerise mbartin rrezikun e veprimitarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

NENI 11 : ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise do te jene: ASAMBLEJA E ORTAKEVE DHE ADMINISTRATORI. Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohen sipas neneve te me poshtne te ketij statuti.

NENI 12 ASAMBLEJA E ORTAKEVE :

Asambleja e Ortakeve perbehet nga te gjithe ortaket e Shoqerise.

- 12.1 Ortaku ka te drejte te njihet ne cdo kohe me te gjithe dokumentacionin qe disponon Shoqeria ne ushtrim te aktivitetit te saj dhe te hyje lirisht ne seline e shoqerise.
- 12.2 Ortaku ka te drejte te lajmerohet me poste ose faks te pakten 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Njoftimi duhet te permbate sakte rendin e dites, dokumentacion e pergatitur per tu shqyrtuar si edhe vendin ku do te kryhet mbledhja. Lajmerimi behet nga administratori ose eksperti kontabel i autorizuar. Ortaket nuk jane te detyruar te marrin ne shqyrtim ceshtje per te cilat nuk jane te njoftuar. Mosdhenia e njoftimit per Mbledhjen e Ortakeve e ben te pa vlefshem cdo vendim te marre ne nje mbledhje te tille.
- 12.3 Ortaket mund te lajmerohen edhe me vone se afati percaktuar me lart per ceshtje te karakterit urgjent, zgjidhja e te cilit i nenshtrohet vendimit te Asamblese. Ne kete rast mbledhja nuk anullohet kur te gjithe ortaket jene prezent personalisht ose nepermjet perfaqesimit me ane te prokures.
- 12.4 Ortaket kane te drejte te autorizojne njeri tjeterin ose persona te tjere per t'i perfaqesuar ne mbledhjen e Asamblese.

Neni 13 : MBLEDHJA E ORTAKEVE

13.1. Mbledhja e ortakeve mbahet ne :

- Seline e Shoqerise
- Ne nje vend tjeter njoftuar ne lajmerim dhe te pranuar nga ortaket
- Me vendim qarkullues, pervec vendimit qe miraton bilancin, destinacionit te fitimit dhe ndryshimin e statutit i cili kerkon prezencen fizike te ortakeve .

- 13.2 Cdo ortak qe perfaqeson te pakten 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise ka te drejte te kerkoje mbledhjen e asamblese, duke percaktuar njekohesisht edhe rendin e dites.

13.3 Cdo ortak ka te drejte te marre pjesë ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

13.4 Per cdo Mbledhje te Ortakeve procesverbali i mbajtur duhet te jape hollesi mbi ceshjet e meposhtme :

- Datën, vandin dhe natyren e mbledhjes
- Procedura e perdorur per te therritur mbledhjen
- Rendin e dites
- Emrat e ortakeve pjesmarres
- Nese eshte arritur kuorumi i nevojshem
- Diskutimet e mbajtuara ne mbledhje
- Vendimi i Asamblese
- Rezultatet e Vendimit

13.5 Mbledhja e ortakeve mund te drejtohet nga administratori ose ortaku me i vjeter ne moshe.

13.6 Procesverbali i Mbledhjes mbahet nga administratori dhe pas zbardhjes nenshkruehet nga te gjithe ortaket.

Neni 14 : KOMPETENCA E ASAMBLESE SE ORTAKOVE

1. Miratimi i bilancit te shoqerise.
2. Miratimi i destinacionit te shoqerise
3. Ndryshimin e kapitalit
4. Shtimin e objektit te aktivitetit te shoqerise
5. Blerje – shitje te objekteve te patundshme per llogari te Shoqerise
6. Miratimin e marrjes se kredise nga Bankat e nivelit te dyte dhe te dhenies se garancise per garantimin e kredise.
7. Miratimin e operacioneve mbi 30.000 EUR ose ekuivalentet e saj ne LEKE.
8. Ndryshimin e statutit
9. Emerimi i Ekspertit Kontabel
10. Miratimin e shperblimit te administratoreve
11. Hapjen e zyrave te perfaqesimit, filialeve ose degeve te tjera te shoqerise brenda e jashtë vendit.
12. Miratimin e vleresimeve te eksperteve mbi kontributet ne natyre te kapitalit statuor.
13. Emerimin e Administratorit
14. Emerimin e likuidatorit
15. Miratimin e shkrirjes, bashkimin, likuidimin e shoqerise.
16. Miratimin e krijimit, perdorimit, shperndarjes se rezervave te Shoqerise
17. Emeron perfaquesues ad hoc ne rast te verifikimit te pikes 16.5 te statutit

NENI 15 : VENDIMI I ASAMBLESE

15.1 Votimet qe lidhen me pikat 1,2,4,5,6,7,9,10,11,12,13,14,17 kerkojne shumice $50 + 1$ te ortakeve qe perfaqesojnë kapitalin themeltar. Ne rast se nuk arrihet te sigurohet kjo shumice mbledhja e ortakeve perseritet pas 15 diteve dhe vendimi merret me shumicen e votave te dhena, pavarsisht nga perqindja e kapitalit qe perfaqeson.

15.2 Votimet qe lidhen me pikat 3, 8, 15, 16 kerkojne votimin e ortakeve qe perfaqesojnë $\frac{3}{4}$ e pjesave te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 16 : ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 16.1. Drejtimi dhe administrimi i shoqerise "AutoMaster" sh.p.k. do te behet nga z. Berzh Piranjani.
- 16.2. Administratori i Shoqerise zgjidhet per nje afat kohor 3 vjecar. Ai mund te riemerohet porsi nga Asambleja e Ortakeve.
- 16.3. Administratori sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike e financiare puneson persona te ndryshem. Rregullat e marrjes ne pune do te percaktohen me nje rregullore te vecante qe do te pregetitet nga administratori dhe miratohet nga mbledhja e themeluesve brenda tre muajve nga data e regjistrimit.
- 16.4. Administratori perfaqeson Shoqerine tek personat e trete dhe kryen cdo veprim administrimi qe nuk i perket ortakeve. Ortaket mund ti delegojne kompetanca e tyre administratorit i cili eshte i detyruar te kryeje veprimet konform autorizimit perkates.
- 16.5. Administratori nuk mund te operojne me llogarite e Shoqerise ne Bankat e nivelit te dyte kur atyre u eshte kerkuar doreheqja nga ortaket qe perfaqesojnje 50+1 te kapitalit themeltar.

16.6. MBARIMI I MANDATIT TE ADMINISTRATORIT

1. Mbaron afatin e percaktuar ne pikën 16.2
2. Shkarkohet per shkaqe te arsyeshme nga Asambleja e Ortakeve
3. Jep doreheqjen
4. Arsyet shendetesore nuk i lejojne kryerjen e detyres se tij funksionale

NENI 17 RREGJISTRIMI NE AUTORITET PERKATESE

Shoqeria tregetare "AutoMaster sh.p.k." deklarohet e krijuar me zbatimin e plete te normave qe permban ky statut dhe legjislacioni shqipetar ne fuqi. Ajo fiton zotesine e saj per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe ushtron veprimtarine ekonomike me rregjistrimin ne organin perkates tatimor.

NENI 18 PUNESIMI

Maredhieniet e punes Shoqeria merr persiper te respekoje rregullat e punesimit ne R.SH. dhe sig. shoqerore, ndersa te gjithe te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e shoqerise. Mardhieniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kete kontrate zbatohen dispozitat e legjislacionit shqipetar ne fuqi. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqipetare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

NENI 19 MBYLLJA E BILANCIT

Bilanci dhe te ardhurat, veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin ne Janar dhe do te mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore bilanci kontabel mbylljet sipas ligjeve ne fuqi. Bilanci kontabel i nenshtrohet miratimit te ortakeve .

NENI 20 DISPOZITA TE TJERA


Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje administratori si dhe ligjive te vecanta te legjislacionit shqipetar. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejtene menyre e procedure me te cilin nxirret vete statuti.

Ky statut perpilohet ne disa kopje per tju shpendare organeve kompetente si dhe nje kopje mbeten ne dokumentacionin baze te kesaj shoqerie. Statuti miratohet nga ortaket nenshkruehen nga ata rregullisht.

THEMELUESIT

UNION GRUP SHPK

Perfaqsuar nga Z. Niko LEKA

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Niko Leke" above a stylized, cursive "my".